



Funded by
the European Union



Tiranë, 16/02/2021

NJOFTIM PËR SHTYP



Bashkimi Evropian dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri lançuan një nismë të re për modernizimin e mbrojtjes së të dhënave në Shqipëri, nëpërmjet projektit të binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* e Bashkimit Evropian”.

Më datë 16 shkurt, 2021, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri mbajti takimin e parë lançues të projektit të binjakëzimit, financuar nga Bashkimi Evropian “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* e Bashkimit Evropian”.

Projekti i binjakëzimit po zbatohet nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Garante per la Protezione dei Dati Personali*”, mbështetur nga CSI Piemonte, Itali dhe Instituti për të Drejtat dhe Liritë Themelore *Ludwig Boltzmann*, Austri.

Ky projekt synon përafrimin e kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri me atë të *acquis* së BE-së, më konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të të Dhënave Personale të BE-së 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë së BE-së 2016/680.

Ky takim i cili u zhvillua online, u hap nga z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri dhe vijoi me z. Zef Mazi, Kryenegociator i Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit në BE, z. Mario Mariani, Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së në Shqipëri, z. Alberto Petrangeli, Zëvendësambasador i Italisë në Shqipëri, znj. Renate Seib, Zëvendësambasadore e Austrisë në Shqipëri.



Ndër folësit kryesorë të takimit ishin gjithashtu znj. Jutta Gutzkow, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, znj. Adea Pirdeni, Zëvendësministre e Drejtësisë, z. Pasquale Stanzione, President i Autoritetit Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pjesëmarrës të tjerë nga institucione, si dhe pjesëmarrës nga projekte të BE-së.

Rrezultati më i rëndësishëm që u prezantua gjatë takimit si një arritje e madhe deri më tani, ishte hartimi i një drafti të parë të konsoliduar për ligjin e ri mbi mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. Gjithashtu, gjatë takimit u theksua rëndësia e projektit në lidhje me procesin e integritetit të Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe fakti se mbrojtja e të dhënave mbetet një sfidë globale.

Komisioneri Dervishi në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se jemi në një fazë të rëndësishme në të cilën projekti i binjakëzimit po vendos bazat më të forta, duke garantuar përafrimin me GDPR. Po ashtu, Zyra e Komisionerit ka siguruar miratimin në parim të aderimit të Shqipërisë në Konventën 108 +.

Z. Mariani, Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së në Shqipëri theksoi se, mbrojtja e të dhënave personale nuk është vetëm një politikë, por edhe një vlerë e BE-së dhe një e drejtë themelore për të gjithë qytetarët e BE-së. Ai përgëzoi institucionet shqiptare dhe të gjithë partnerët për bashkëpunimin e ngushtë, punën e bërë dhe arritjet e deritanishme në kuadër të projektit për mbrojtjen e të dhënave, pavarësisht faktit se situata Covid -19 përbënte një sfidë të jashtëzakonshme. Për më tepër, ai nënvizoi se Delegacioni i BE inkurajon të gjitha vendet anëtare të bashkëpunojnë me institucionet shqiptare në procesin e përafrimit gradual me ligjet e BE-së.

Në takimin lançues të këtij projekti, pjesëmarrësit vlerësuan koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv të deritanishëm, pavarësisht sfidave për t'u përballur për shkak të situatës Covid-19 dhe theksuan se si përfaqësuesit e vendeve anëtare dhe të vendit përfitues do të jenë plotësisht të angazhuar deri në përfundimin e zbatimit të këtij projekti. Një prezantim i përgjithshëm i zbatimit të projektit që prej fillimit të zbatimit të tij deri tani iu paraqit pjesëmarrësve, me qëllim informimin në lidhje me rezultatet e prekshme të arritura deri sot.

Kuadri i ri rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale përbën një kontribut të rëndësishëm në rrugën e *integritetit evropian* të Shqipërisë. Ky projekt mundëson që qytetarët shqiptarë të përfitojnë nga modernizimi i legjislacionit në këtë fushë dhe për afrimi me standardet e BE-së për të drejtat e mbrojtjes së të dhënave personale.

Nëpërmjet miratimit të tij, qytetarët do të kenë kontroll më të madh mbi procesin e përpunimit të dhënave. Risitë kryesore të legjislacionit të ri paraqesin koncepte të reja, të cilat shkojnë paralelisht me zhvillimin e teknologjisë si mënyra të reja të dhënies së pëlqimit, e drejta për t'u harruar, koncepte të tjera inovative si transportimi i të dhënave, privatësia sipas parazgjedhjes dhe sipas modelit (privacy by default and by design) dhe sanksione më të forta për shkeljet e ligjit. Përveç risive të paraqitura në përputhje me GDPR dhe forcimit të direktivës, nëpërmjet këtij ligji është përpjekur të sigurohet një institucion më i fortë, ai i Komisionerit në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë sfidave që paraqiten për çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale, por gjithashtu të qëndrojnë në kontekstin e brendshëm.

Në përmbyllje të takimit, z. Dervishi siguroi pjesëmarrësit për angazhimin dhe vullnetin e tij personal dhe të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendit përfitues dhe të gjithë partnerëve të përfshirë, me qëllim përbushjen e objektivave të projektit me sukses.



Më shumë informacion rreth Projektit të Binjakëzimit gjeni në faqen e Zyrës së Komisionerit në menynë Tëinning (link): <https://www.idp.al/twinning/>

Të plotë ceremoninë mund ta konsultoni në kanalin zyrtar të Zyrës së Komisionerit në YouTube në lidhjen (link): <https://youtu.be/ixyUJveNIn0>

Partnerët e Projektit të Binjakëzimit:

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shqipëri
- Garante per la Protezione dei Dati Personali (GPDP), Itali
- CSI – Piemonte (CSI), Itali
- Ludwig Boltzmann Institute of Fundamental and Human Rights, Austri

